



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.09.2017, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 25.09.2018.
2. Diskutimi i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””
(nismë e 37 mijë zgjedhësve)

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Luan Duzha, Luan Harusha, Elona Hoxha, Vullnet Sinaj, Klodjana Spahiu, Milva Ekonomi, Paulin Sterkaj.

Mungojnë:

Andon Frrokaj, Anduel Xhindi, Sadi Vorpsi, Luan Rama, Myslym Murrizi, Ervin Salianji, Flamur Noka, Endrit Brahimllari, Xhemal Gjunksi, Isuf Çelaj.

Të ftuar:

Indrit Osmani – Drejtor Ekzekutiv i *Animal Rescue* (OJQ në ndihmë të kafshëve)

Jonel Kristo – Anëtar i Bordit Drejtues të *Animal Rescue*

Ilir Bejko - Drejtor i Oponencës Ligjore (Ministria e Drejtësisë)

Gërzhet Akshia – nga Ministria Turizmit dhe e Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita!

Hapim mbledhjen e Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare. Në mbledhjen e sotme të komisionit, kemi planifikuar miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 25.09.2018. Besoj se nuk ka vërejtje nga kolegët dhe kështu, kemi mundësi të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, në diskutimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Të ftuar për të bërë prezantimin e këtij projektligji janë të pranishëm kemi të pranishëm zotin Indrit Osmani, drejtor Ekzekutiv i *Animal Rescue* (një OJQ në ndihmë të kafshëve), të cilit i urojmë mirëseardhjen. Po kështu, kemi thirrur në komision zotin Jonel Kristo, anëtar i Bordit Drejtues të OJQ-së *Animal Rescue*, zotin Ilir Bejko, drejtor i Oponencës Ligjore (Ministria e Drejtësisë) dhe zonja Gërzhet Akshia nga Ministria Turizmit dhe e Mjedisit.

Ka ardhur përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, apo jo?

Faleminderit, zonja Akshia, që jeni bërë pjesë mbledhjes së komisionit tonë!

Paraprakisht, dua të bëj me dije kolegët deputetë të këtij komisioni se në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar që më 6 nëntor 2017, pothuajse 1 vit më parë, një nismë e OJQ-së “*Animal Rescue*”. Kësaj nisme i janë bashkuar edhe qytetarë të tjerë. Janë depozituar 37 527 firma, të cilat, sipas edhe asaj që ne kemi parashikuar në Kushtetutën e RSH-së, bëjnë të mundur ardhjen e një iniciative ligjore nga qytetarët para Kuvendit të Shqipërisë.

Konkretisht, propozohet që Kodit Penal t’i shtohet një kre i ri me disa vepra penale. Kreu të titullohet: “Vepra penale kundër mirëqenies së kafshëve”. Për t’u njohur me projektin e kësaj organizate do të ftoja përfaqësuesit e organizatës për të prezantuar këtë projekt në komision dhe më pas, natyrisht do të donim të dëgjonim edhe mendimin e përfaqësueses së Ministrisë së Mjedisit. Sigurisht, do të ishte e domosdoshme të kishim edhe përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë në dëgjesën për këtë projekt.

Kush do ta marrë fjalën nga ju? Zoti Osmani?

Urdhëroni, zoti Kristo!

Jonel Kristo – Ju falënderoj shumë për kohën që po i jepni kësaj çështjeje!

Nisma që kemi marrë ka lindur para shumë kohësh dhe unë besoj se ju jeni të familjarizuar me të gjitha rastet e keqtrajtimit të kafshëve në Shqipëri, sidomos në

Tiranë. Për këtë arsye ishte e nevojshme që të merrej një masë më shumë sesa thjesht është kauza jonë, më shumë sesa thjesht është aktivizmi ynë, më shumë sesa thjesht janë protestat që ne bënim herë pas here.

Kështu që, para jush sjellim ndryshimin në Kodin Penal dhe shtimin e një kreu të ri atje, për trajtimin e rasteve të keqtrajtimit të kafshëve, sidomos të kafshëve endacake, nismë kjo e firmosur prej 37500 qytetarësh shqiptarë. Flasim këtu për rregullimin e rasteve kur qentë dhe macet vriten në rrugët e Shqipërisë me paramendim, pra në kundërshtim me ligjet aktuale që ne kemi, si, për shembull, ai i veterinarisë. Por ne do të donim që, nëpërmjet këtij kreu, të fusim në Kodin Penal parashikime për dënime me burgim dhe gjobë për personat që keqtrajtojnë me dashje, pa qenë i nevojshëm, pra jashtë parashikimeve të sëmundjeve e të tjerë, keqtrajtimi i kafshëve endacake. Këtë nuk e bëjmë nga shpirti ynë, as sepse jemi kaq të ndjeshëm, por sepse është një veprim qytetar që duhet bërë dhe sepse zgjidhja e duhur nuk është ajo që po bëjmë aktualisht. Ne po e bëjmë këtë, sepse, sikundër po funksionojnë shumë nga qeveritë vendore, të cilat mendojnë se po i japin zgjidhje situatës së kafshëve endacake... Të gjithë ne kur shkojmë në çdo qytet, shkoni në Librazhd, në Përrenjas apo kudo tjetër, bezdisemi nga kafshët në rrugë. Ato kanë vite që vriten dhe në qoftë se situata do të zgjidhej, nisur edhe nga fakti që ato vriten prej vitesh, kjo nuk është zgjidhur. Prandaj ishte shumë e thjeshtë të logjikoni se ajo nuk është zgjidhja. Në fakt, zgjidhja është ajo që kanë bërë shumë vende europiane, shumë vende perëndimore që në vitet 1991-1992, siç është rasti i Lituanisë, e cila ka ligj për ndalimin e vrasjes së kafshëve që në vitin 1992. Pra, kur ne kishim edhe një javë bukë për të ngrënë akoma, Lituania kalonte ligjin për të drejtat e kafshëve, ku ndalohej vrasja e tyre.

Atëherë, nëpërmjet këtij ligji fillimisht ndërtojmë një barrierë që njerëz të tillë të mos kryejnë vrasje të tilla dhe, e dyta, japim se cila do të ishte zgjidhja. Këtë ne e kemi bërë prej kohësh tashmë, duke analizuar modele të ndryshme të ligjeve ndërkombëtare dhe duke sjellë përpara komisionit një shtesë në Kodin Penal, kreu XII, që do të adresonte pikërisht këto.

Kjo është pak a shumë në thelb. Unë shpresoj shumë që të jemi në ditën historike që diçka e tillë të kalojë.

Ermonela Felaj – Kolegu dëshiron të shtojë diçka lidhur me këtë nismë?

Jonel Kristo – Po, dua të shtoj diçka. Nëse mund të përmend disa vende, të cilat e kanë ndërmarrë këtë nismë para nesh. Janë pothuajse të gjitha vendet europiane, si: Gjermania dhe Austria, që i kanë, në fakt, në preambulën e Kushtetutës; Franca e ka në Kodin Civil dhe në

Kodin Penal; Danimarka, Italia e të tjerë. Gjithashtu, dua të theksoj se drafti që i është paraqitur sot Kuvendit është shumë i ngjashëm, madje për hartimin e tij janë marrë për bazë nenet 554 e në vazhdim të Kodit Penal Italian. Vende të tjera janë: Irlanda, Sllovenia, Spanja, Suedia, Finlanda, Estonia, Republika Çeke, për të ardhur në rajoni tonë Bosnja, Kroacia dhe Maqedonia janë të gjitha vendet e Europës. Domethënë, Serbia, Rumania, Portugalia dhe Polonia janë të gjitha vende, të cilat kanë parashikuar, dikush më mirë dhe dikush pak më mirë, mbrojtjen e kafshëve nga keqtrajtimi, nga dhuna dhe nga vrasja.

Ermonela Felaj – Në fakt, zonja Akshia, jemi munduar që t’ua vëmë në dispozicion projektligjin më herët, prandaj dua që të kemi opinionin tuaj si ministri, që ka përgjegjësitë e saj në këtë pjesë.

Gerzheta Akshia - Faleminderit, për ftesën dhe për rëndësinë që i jepni kësaj teme!

Lidhur me nismën e qytetarëve, bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për miratimin e disa dispozitave kundër dhunës ndaj kafshëve në Kodin Penal, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, me politikbërjen e saj i jep një rëndësi kësaj çështjeje. Në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, edhe legjislacioni shqiptar duhet të përafrohet për mbrojtjen e kafshëve. Prandaj është e rëndësishme mbrojtja e kafshëve, si për rëndësinë mjedisit, ashtu edhe për turizmin. Kështu që, me politikbërje Ministria e Turizmit dhe Mjedisit jep dhe do të japë rëndësinë e saj.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në fakt, për shkak të axhendës së Kuvendit të Shqipërisë, për shkak të spostimit të seancës plenare, kalendari i Komisionit të Sigurisë ndryshoi gjatë kësaj jave, kështu që nuk patëm shumë kohë me kolegët. Prandaj kam marrë përsipër që të jem relatore e këtij projekti.

Së pari, dua të falënderoj iniciatorët për nismën, për faktin se nuk i shikojmë shpesh nismat e qytetarëve në Kuvendin e Shqipërisë, nismat e 20 mijë qytetarëve me të drejtë vote për të bërë një ligj, dhe ky është një shembull i mirë që ju jeni duke dhënë. Pra, mund t’i numërojmë me gishtat e dorës dhe ka kaluar shumë kohë që kur mund të kemi parë nismën e fundit, të materializuar deri në pikën kur vjen në një dëgjese para një komisioni parlamentar.

Nga ana tjetër, dua të them se ne vihem në lëvizje si komision për faktin se nisma juaj kërkon të fusë një ndryshim në Kodin Penal, por Kodi Penal në vetvete, në fakt, është cilësuar si një ligj ndëshkues, ndëshkime të nivelit të tillë, që heqin ose kufizojnë lirinë e personave. Në

këtë pikëpamje ne kemi të gjithë tagrin si, Komisioni i Sigurisë Kombëtare, që ta çmojmë këtë balancë, balancën ndërmjet nevojës për të mbrojtur kafshët dhe mundësisë që krijohet për t'u hequr lirinë personave, prandaj edhe ky ligj është objekt i komisionit tonë.

Sa herë që diskutohet për Kodin Penal, janë të paktën dy komisione që vihen në lëvizje, Komisioni ynë dhe Komisioni i Ligjeve. Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe, natyrisht, do të japim disa mendime të natyrës teknike, sepse kur na vjen ligji duhet të diskutojmë teknikisht.

Unë po kaloj direkt në sugjerimet apo vërejtjet e mia që kam për këtë projekt dhe dua t'i ndaj me ju dhe kolegët.

Ju propozoni që Kodit Penal t'i shtohet një kre i ri, ndërkohë që Kodi Penal shqiptar ka 11 krerë dhe ju propozoni të shtohet një kre i 12-të, të cilin e keni titulluar “Vepra penale kundër mirëqenies së kafshëve”. Ky kre, që ju propozoni për amendim në Kodin Penal, përmban gjithsej 6 nene, që në vetvete përfaqësojnë figura të ndryshme të kryerjes së veprimeve të dhunshme ndaj kafshëve. Kodi Penal në kreun IV, i cili bën fjalë për veprat penale kundër mjedisit, përmban disa nene, nga neni 201-207, ku trajtohen ndotja e ajrit, transportimi i mbeturinave toksike, ndotja e ujërave, peshkimi i ndaluar, prerja e paligjshme e pyjeve, prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë, shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor, shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor dhe shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve. Pra, aktualisht, ajo çfarë përfaqëson mjedisi, flora dhe fauna, gjejnë mbrojtje në këtë kre të Kodit Penal me këto nene. Sigurisht që ne edhe më parë kemi shtruar nevojën që ky kre i Kodit Penal duhet të reformohet, sepse është nga të paktët krerë të Kodit Penal ku nuk është ndërhyrë ose është ndërhyrë shumë rrallë, ku pjesa më e madhe e dispozitave të këtij kreu “Veprat penale kundër mjedisit” janë të tilla që nga viti kur është miratuar Kodi Penal, viti 1995. Realiteti për sa i takon krimin mjedisor ka ndryshuar rrënjësisht, është përshkallëzuar më së shumti për keq dhe jo për mirë dhe patjetër unë do të shfrytëzoj rastin, meqenëse është edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, të nxisë të dyja ministritë që të realizojnë përgjegjësitë e tyre. Ashtu sikundër qytetarët marrin iniciativë dhe propozojnë nisma, ashtu edhe autoritetet dhe institucionet qendrore, e kanë për detyrë të sjellin nisma që reflektojnë të gjitha realitetet e reja. Pse e mora për bazë këtë gjë?! Për faktin se ju keni propozuar disa nene, të cilat vetëm si numër e kalojnë numrin e veprave penale që trajtojnë krerë të tjerë, të cilët janë shumë herë më të rëndësishëm për sa i përket objektit të tyre se kreu që propozohet. Fjala vjen, ne nuk kemi kaq

figura veprë penale për terrorizimin, ose, kur na u desh të futnim në Kodin tonë Penal dispozita që trajtonin luftëtarët e huaj, kemi futur vetëm dy dispozita. Kjo do të thotë se ky Kod ka një balancë dhe një strukturë të caktuar, e cila, natyrisht, duhet të respektohet, sepse Kodi Penal është ligji i cilësuar dhe duhet të bëhet shumë kujdes në shkrimin e tij. Natyrisht që unë e kuptoj vështirësinë që has një qytetar apo një 20 mijë qytetarë për të shkruar një projekt dhe për ta sjellë në një formë mirëfilli ligjore, sepse kuptohet që edhe kapacitetet njerëzore dhe *background*-i nuk janë të tilla që t'i ndihmojnë të shkruajnë një ligj. Pra, të shkruash një ligj, nuk është gjëja më e lehtë, përkundrazi është gjëja më e vështirë, mendoni sa e vështirë është të shkruani një ligj të cilësuar! Kështu, së pari, do t'ju ftoj ta rishikoni kapitullin ekzistues të Kodit Penal, kreun ekzistues “Vepra penale kundër mjedisit”, duke nominuar aty si figura të veprave penale ato që janë më të ndeshurat dhe më të rëndat, të cilat paraqesin rrezikshmëri shoqërore. Kjo pjesë e analizës është shumë e rëndësishme. Ajo që ju thatë me të drejtë, dhe ne si qytetarë i kemi ndjekur transmetimet e ndryshme të emisioneve televizive lidhur me dhunën që ushtrohet ndaj kafshëve të rrugës ose jo. Patjetër nuk është se këto lloj shfaqesh na kanë bërë të ndihemi mirë, absolutisht. Është e vërtetë që gjithsecili ka pasur një reagim të brendshëm që këto lloj shfaqesh duhet të marrin fund. Nga ana tjetër, jo çdolloj veprimi, që duket i papëlqyeshëm, i papajtueshëm me logjikën e të gjithëve, mund të konsiderohet veprë penale. Ajo mund të jetë një shkelje e një niveli tjetër. Për shembull, mund të jetë shkelje administrative që ndëshkohet me gjobë. Pra, që të ngrihesh në nivelin e një veprë penale, duhet të shikosh nëse realizohen të gjitha elementet e një veprë penale. Në rastin konkret duhet të vlerësohet rrezikshmëria shoqërore. Nëse ligjzbatuesit, gjykatat, prokuroria, do të dënojnë dikë, e kanë për detyrë që kur kërkojnë dënim dhe caktojnë dënim, të marrin parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit. Të dyja këto bashkë janë të pandara dhe çmohen në bazë të faktit që i atribuohet personit konkret. Besoj se kuptohemi deri këtu. Do të thosha se për këtë arsye edhe për faktin që në dispozita propozohen dy lloj dënimesh kryesore: kërkohet edhe dënimi me gjobë edhe burg, kjo është një gjë e shfuqizuar tashmë nga Gjykata Kushtetuese. Në Shqipëri është konsideruar e papajtueshme me Kushtetutën dhënia e dy dënimeve kryesore. Unë e di që legjislacione të tjera në Francë, Itali e aplikojnë dhënien e dy dënimeve kryesore njëherazi, por në Shqipëri ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që ka një fuqi, e ndalon dhënien e këtyre vendimeve. Patjetër që edhe masat e dënimit duhet të çmohen në raport me rëndësinë e faktit.

Unë i pashë me vëmendje të gjitha figurat e krimit, të gjitha figurat që propozoni si figura të veprave penale janë krime, nuk ka asnjë kundërvajtje në to. Ndërkohë po t'i shikosh në raport me vepra të tjera penale që duken më të rënda, ato dënohen më pak sesa propozimi që keni ju. Pra, duke ecur kështu hap pas hapi do të gjykoja që kontributit dhe iniciativës suaj të mirë, duhet t'i bashkohen edhe Ministria e Drejtësisë, edhe Ministria e Mjedisit me qëllim që këtë draft që i keni sjellë Kuvendit të Shqipërisë të mund ta sillni në formën e duhur dhe në gjuhën e duhur, sepse Kodi Penal nuk mund të ketë në pjesë të tijin, sikurse edhe çdo ligj një gjuhë të ndryshme, por duhet të ruajë të njëjtën gjuhë, kjo është gjuha e ligjit. Iniciativa juaj është shumë e mirë, vërtet e guximshme në kuptimin që ju keni ardhur deri këtu, por ajo patjetër duhet të përkthehet në gjuhën e ligjit. Këtij drafti i mungon një relacion që të mund të shpjegonte për çdo vepër që ju propozoni objektin, anën objektive, subjektin, anën subjektive të saj.

Nga ana tjetër i mungon edhe justifikimi publik. Le të marrim gjënë që e kemi më problematikë në praktikë, që e kemi fenomenin më të përhapur, të biem dakord që këtë ta vendosim në Kodin Penal.

Edhe një argument i fundit Kodi Penal, që në hyrje të tij parashikon detyrat e legjislacionit penal. Aty thuhet konkretisht: "Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si edhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si edhe parandalimin e tyre". Pra, këto janë detyrat që duhet të realizojë ky ligj. Po të vini re, renditja nuk është e rastësishme, por vjen sipas rëndësisë. Kështu, edhe ne duhet t'i japim kësaj nisme vendin që i takon në Kodin Penal, e atë që i takon.

Si relatore e këtij projekti, këtë sugjerim do të kisha për ju.

Më lejoni të them edhe diçka tjetër: përpara se ta fillonim këtë mbledhje, në njëfarë mënyre edhe për të mos u paragjykuar, unë i pyeta kolegët anëtarë të këtij komisioni, se cili nga kolegët kishte kafshë, pra mbante kafshë.

Në fakt, krejt për rastësi, shumica e kolegëve këtu kanë kafshë, qen ose mace. Kësisoj, natyrisht që e kuptojnë shumë mirë atë çfarë ju kërkoni, dhe patjetër që janë dashamirës të nismave të tilla. Pra, dua t'iu bëj me dije se nuk ka asnjë lloj paragjykimi në lidhje me këtë pjesë, veçanërisht në këtë komision, ku qëllon që anëtarët ta kenë këtë lloj ndjeshmërie.

Le të bëjmë gjënë e duhur nëpërmjet kësaj mënyre, e cila besoj se është më e mira. Ndërkohë, prapë do të përfitoja nga rasti për t'i kërkuar përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë, e mediatikisht edhe Ministrisë së Mjedisit, që kësaj iniciative t'i bashkojnë edhe një iniciativë tjetër. Sepse, aq sa është e rëndësishme t'i mbrojmë kafshët nga sjellje atipike, po themi, sjellje të palogjikshme, sjellje të dhunshme, po aq e rëndësishme është edhe t'i mbrojmë kafshët në rastet kur ato përdoren në mënyrë krejt të papërshtatshme, duke rrezikuar kështu edhe humbjen e jetëve njerëzore.

Edhe kjo është një ndjeshmëri në opinionin publik. Natyrisht, ky nuk është objekti i organizatës tuaj, por gjithsesi përbën një ndjeshmëri në opinionin publik, e për rrjedhojë na takon t'i përgjigjemi si ligjvënës.

Deri këtu ishte fjala ime. Sidoqoftë, përpara se të mund të merrnim një vendim për këtë, vendim që do t'i përcillet në formë sugjeruese Komisionit të Ligjeve, sepse është pikërisht ai komisioni, i cili do të vendosë përfundimisht në lidhje me këtë nismë, do të doja t'i ftoja kolegët deputetë për pyetje, por edhe për diskutime, në rast se nuk do të kishin pyetje për ju.

Po, zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, unë e përshëndes si nismë, por dua të theksoj atë që tha kryetarja e komisionit.

E para, një projektligj nuk mund të vijë pa një relacion sqarues. Ne duhet ta kuptojmë se në çfarë situatë ndodhemi? Për cilat kafshë bëhet fjalë? Kafshë që janë me certifikatë apo që janë të matrikuluara, se nuk e di si quhen? Kafshë që gjenden masivisht në territor, të cilat janë të paregjistruara askund? Sepse edhe ne kemi një situatë problematike për sa u përket kafshëve, sepse ata që kanë kafshë të certifikuar nuk sillen keq, por i trajtojnë shumë mirë, kjo dihet.

Po për cilat kafshë bëhet fjalë? E para, ne duhet të bëjmë evidentimin, regjistrimin, vaksinimin e të tjera, se nuk i di të gjitha etapat. Pra, duhet të kalohen të gjitha fazat, sepse ne shkojmë te penalizimi, por ne nuk e dinë situatën në të cilën ndodhemi.

E dyta, çfarë veprimesh janë evidentuar realisht ndaj këtyre kafshëve, kafshëve që i mbajnë në shtëpi, që i kanë të regjistruar dhe të tjerët që nuk janë të regjistruar?

Pra, duhet të kemi një bilanc. Në relacion është i domosdoshëm para një projektligji. Çdo projektligj që vjen këtu, edhe kur vjen nga qeveria, shoqërohet me një relacion shpjegues dhe për sa kohë një relacion shpjegues nuk ekziston, ne nuk jemi në gjendje të japim mendim për këtë projektligj.

Unë mendoj se ju duhet të uleni e ta bëni këtë relacion, se sot nuk është koha që ne ta marrim në shqyrtim nen për nen e të japim mendim, për sa kohë nuk kemi një relacion shpjegues nga ana juaj, që të kuptojnë realisht se cila është situata në lidhje me kafshët në Shqipëri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ndreu!

Urdhëroni , zoti Sterkaj!

Paulin Sterkaj – Në radhë të parë, përshëndes këtë iniciative dhe, në radhë të dytë, jam njëqind për qind dakord me kryetarin e Komisionit të Sigurisë Kombëtare.

Te neni 2, pika 5, thuhet: “Kryerja e veprave që bien ndesh me mirëqenien e kafshëve apo mbajtjen e tyre në kushte të papërshtatshme higjieno-sanitare dënohet me gjobë 100-200 mijë lekë ose me burgim deri në 6 muaj”.

A e ke idenë që në Shqipëri ka probleme dhe mbahen fëmijët në kushte jo higjieno-sanitare e në kushte të papërshtatshme? Kush duhet të dënohet në këto raste? Çështja e kushteve është çështje e mirëqenies, prandaj këto janë gjëra që te ne bien ndesh edhe më duket i parakohshëm si ligj.

Do të isha dakord që të mbështesnim Kodin Penal, ta zbërthenim atë pikën që ka të bëjë me mjedisin. Jam dakord edhe me zotin Ndreu, i cili tha se duhen parë edhe shqetësimet që ka ky vend, për cilat kafshë bëhet fjalë.

Se ka edhe nene të tjera për kafshët që futen në punë. Tradicionalisht, shumë kafshë janë përdorur për punë dhe janë mjete pune për bujkun, i cili sot ndoshta nuk ka asnjë lloj mundësie tjetër për të bërë punë, veçse me kafshët, sepse nuk ka rrugë makine, s’ka rrugë traktorësh dhe është i detyruar të përdorë kafshën, mushkën, kalin, gomarin. A thua edhe këta duhet t’i dënojmë me burg? Prandaj nuk na keni cilësuar asgjë konkrete në këtë projektligji që keni sjellë. Mirë do të ishte që ta bëni relacionin, ku të theksoni se për cilat kafshë bëhet fjalë për të egrat apo për shtëpiaket, për të punës apo të luksit dhe ne kuptojmë diçka më shumë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Sterkaj!

Fjalën e ka zonja Ekonomi.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë dua të ndalem në dy gjëra, e para, kjo është një nismë që ia vlen ta përgëzojmë, sepse kjo shoqatë e vogël ka bërë një punë të madhe duke mbledhur firmat e 37 mijë qytetarëve, pra është një nismë e rëndësishme që vlen të përgëzohet për iniciativën që kanë pasur.

E dyta, vlen edhe një gjë tjetër, që është e rëndësishme: Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Mjedisit duhet të ulen dhe të shikojnë këtë kapitull në Kodin Penal, sepse ka ardhur koha që ta përditësojnë dhe të shikojnë edhe me kushtet e reja që janë krijuar në mjedisin shqiptar dhe me sensibilitetin që kanë shqiptarët sot për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj kafshëve. Prandaj besoj se edhe kjo është një gjë e rëndësishme.

Kjo punë do të vazhdojë dhe shoqata që ka punuar deri tani për të sjellë këtë projektide në ligj duhet të jetë e përfshirë në punën e ardhshme për të përditësuar këtë kapitull të Kodit Penal, prandaj do t'u bëja thirrje Ministrive të Drejtësisë dhe të Mjedisit të mos shmangen nga bashkëbisedimi dhe nga bashkëpunimi me këtë shoqatë, sepse ata shumë gjëra mund t'i thonë duke pasur parasysh realitetin praktik në Shqipëri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ekonomi!

Zonja Gjebrea, më fal nëse më lejon, sepse nuk dua që ta shkel procedurën dhe rregulloren, por nga ana tjetër më duhet t'ju them që sapo ka mbërritur përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë.

Fjalën tani e ka zonja Gjebrea, por pastaj do të doja që të prezantoheshit dhe të na jepnit mendimin tuaj për projektin për të cilin jemi duke diskutuar.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë dëshiroj të falënderoj përfaqësuesin e organizatës për këtë nismë të guximshme, e cila ka ndjeshmëri dhe duhet mbështetur. Forma e mbështetjes është kjo që u diskutua dhe që patjetër ka nevojë për rregullime. Por, nëse lexojmë me vëmendje nenet, ka disa gjëra që janë nën juridiksionin e disa shoqatave të tjera, me aq sa kemi parë. Për shembull, përdorimi i lëkurës së kafshëve, për artikujt e lëkurës, siç janë peliçet e të tjera.

Pyetja ime është, a keni bërë ju një tryezë të rrumbullakët me shoqata të tjera që janë në mbrojtje të kafshëve dhe a keni një mendim të unifikuar në lidhje me këtë?

E dyta, është shumë e rëndësishme për të mos përsëritur, mungesë relacioni, që do të thotë që ju ndoshta duhet të krijoni dhe një grup pune me persona, të cilët kanë njohuri për

mënyrën e bërjes së ligjeve dhe, nga ana tjetër, se si ato mund të paraqiten në formën më të mirë të mundshme. Patjetër më pas do të kenë mbështetjen tonë, sipas rregullave që do të kërkohen.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Kush e do fjalën nga përfaqësuesit e Organizatës në Ndhimë të Kafshëve.

Indrit Osmani – Dua të bëj një sqarim, pasi këtu u përmend neni për përdorimin e lëkurës së kafshëve. Në atë nen bëhet fjalë për kafshët shtëpiake, pra për përdorimin e lëkurës së qenve dhe maceve. Ky është përcaktuar si një veprim i paligjshëm, siç e kanë përcaktuar edhe në legjislacionet e tjera europiane. Pra, kur themi se nuk duhet të përdoret lëkura e kafshëve për peliçe dhe veshmbathje, nuk kemi parasysh lëkurën e kafshëve, të cilat njihen gjerësisht se mund të përdoren në industrinë e veshmbathjeve dhe peliçeve.

Për sa i përket relacionit, në fakt, nuk ka qenë detyrim kushtetues që qytetarët të plotësojnë një relacion bashkë me dispozitat apo me ligjet që propozohen. Sigurisht, ne mund ta kishin bërë edhe relacionin, por nuk ka qenë një detyrim. Ne mund ta bëjmë relacionin pa ndonjë problem, por thjesht nuk ka qenë detyrim kushtetues.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, në këtë rast kemi pasur një solidarizim nga qytetarëve. Mund t'ju them se vetëm ditën e parë që kemi bërë thirrje për mbledhjen e firmave, para zyrave të Kryesisë së Kuvendit, kanë ardhur mbi 2 mijë qytetarë. Gjithsesi, iniciativa ligjore nuk erdhi papritur, por erdhi si rezultat i ndjeshmërisë së shumë qytetarëve. Unë e kuptoj se në këtë vend mund të ketë shumë halle dhe shumë probleme të tjera, por kjo nuk do të thotë se një pjesë e qytetarëve të mos kenë të drejtë të kërkojnë të zgjidhin problemet dhe hallet e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gjithsesi, dua të theksoj se është edhe një pjesë tjetër e qytetarëve, të cilët kanë edhe ata problemet e tyre, që ndoshta nuk kanë të bëjnë me varfërinë dhe mjerimin, por me gjëra të tjera. Pra, ka pasur një angazhim shumë të madh të qytetarëve lidhur me këtë nismë. Ndoshta juve ju duket shumë e detajuar, por mund t'ju them se në vende të tjera ka shumë vepra penale, që parashikojnë keqtrajtimin kafshëve, por edhe nga ato që ne hasim çdo ditë. Për shembull, juve mund t'ju duket çudi, në një vend tjetër konsiderohet vepër penal në qoftë se i pret qenit apo maces ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në Itali, ku jemi bazuar thuajse janë identike me Kodin Penal italian ku, për shembull, prerja e veshëve dhe e bishtit të kafshëve shtëpiake konsiderohet si vepër penale.

Këtu në Shqipëri mund të shkosh te veterineri dhe për qejf t'ia presësh veshët dhe bishtin, ndërsa ata i konsiderojnë si gjymtyrë të kafshëve dhe si shkaktim dhune. Në fakt, në këtë projektligj nuk është parashikuar, por e kemi si detaj që mund të parashikohet në një kohë të mëvonshme.

Ermonela Felaj- Çdo Kod Penal ka individualitetin e vet. Fakti që një nen e ka një vend, por nuk e ka një vend tjetër, nuk do të thotë që është gabim, sepse ka shumë aspekte që ndërhyjnë në ndërtimin e një Kodi Penal. Edhe tradita ndërhyr madje. Kur është diskutuar në Kuvendin e Shqipërisë për dekriminalizimin e shpifjes, ka pasur shumë debat, sepse kishte shumë deputetë që mendonin se shpifja është një gjë që duhet të ndëshkohet me burg. Natyrisht, në fund e gjetëm gjuhën dhe erdhëm në atë që bëjnë edhe vendet e tjera sot, e dënojmë vetëm me gjobë shpifjen.

Indrit Osmani -Ka edhe vende si Gjermania që e kanë parashikuar në preambul.

Ermonela Felaj- Ne kemi shfrytëzuar edhe shërbimin mbështetës të Komisionit të Sigurisë, por edhe shërbimin e Bibliotekës së Kuvendit të Shqipërisë, të cilët na kanë vënë në dispozicion materiale sesi operojnë vendet e tjera në këtë drejtim. Për shembull, Franca ka vetëm një nen në këtë pjesë, ka nenin 521/1, Italia nuk ka kaq nene sa ju propozoni, por ka vetëm 4 nene, Mali i Zi ka vetëm një nen, vrasjen dhe torturën e kafshëve.

Ndalemi tek ajo që ne duhet të shohim sa të përhapur e kemi fenomenin, sa mundësi kemi ta parandalojmë atë pa shkuar te heqja e lirisë, sepse, po shkuam aty, është një kosto me e madhe për shoqërinë. Bëhet fjalë për njerëz që do të hyjnë në burg dhe që natyrisht duhet të mendojmë edhe si duhet t'i riintegrojmë këto njerëz.

Po kështu kemi ligjin “Për shërbimet veterinarë në Republikën e Shqipërisë”, nr. 10465, datë 29.09.2011, që mund të jetë një pikë vëmendjeje shumë e mirë për ju dhe ministrinë, pra një ligj relativisht i ri, ku në nenin 1, pikat 8 dhe 9, thuhet: “Ky ligj ka për qëllim të mbrojë kafshët nga tortura dhe të sigurojë mirëqenien e tyre”. Është fjalë për fjalë e njëjtë me qëllimin që ju adresoni në nismën tuaj, pika 9 të mbrojtjes së kafshëve e egra, që edhe kjo është po ashtu. Është që gjë që mund ta shohim. Ose a mund të kemi në Shqipëri një ligj të posaçëm për mbrojtjen e kafshëve? Ka ardhur koha, patjetër. Nuk është se ka munguar vëmendja në këtë pjesë, sepse afati i moratoriumit të gjuetisë është shtyrë dy herë dhe i ka dhënë rezultatet e veta pozitive. Pra, ka

pasur ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri ndaj çështjes dhe unë jam e sigurt që edhe në këtë iniciativë që keni ndërmarrë do të mbështeteni nga institucionet qendrore. I gjithë qëllimi është që të mund ta sjellim në formën e duhur në raport me Kodin Penal, sepse Kodi Penal nuk mund të trajtohet si një letër e thjeshtë bakalli ku kushdo mund të bëj diçka pa llogaritur pasojat që mund të vijnë më pas.

Ne kemi të ftuar përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë, dhe, natyrisht, për transparencë do t'ia vlente të dëgjonim edhe opinionin e tij.

Fjala është për ju.

Ilir Bejko – Përshëndetje!

Më lejoni t'ju kërkoj ndjesë për vonesën!

Quhem Ilir Bejko, jam drejtori i Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Nuk kam pasur kohë për të dhënë një mendim të detajuar dhe përfundimtar për këtë projektligj, por ajo që më bie menjëherë në sy është se një pjesë e tij nuk mund të jetë pjesë e Kodit Penal, por duhet rregulluar në ligjin respektiv për mbrojtjen e kafshëve, ose në atë pjesë të legjislacionit tonë, që merret me këtë pjesë.

Kam pasur mundësinë ta krahasoj me legjislacionin e dy vendeve të tjera, është e vërtetë ajo që thoni, se ata nuk kanë kaq shumë nene në Kodet e tyre Penale për të rregulluar dënimin e kafshëve, si Gjermania dhe Austria, por kanë një ligj paralel për mbrojtjen e kafshëve, në të cilin rregullohet një pjesë e kësaj materie që propozohet për t'u bërë pjesë e Kodit tonë Penal.

Gjëja tjetër që më bie në sy është se, për mendimin tim personal, jo të ministrisë, dënimet me burgim janë shumë të larta, megjithatë më duhet të bëj edhe një analizë më të detajuar, ta krahasoj edhe me legjislacionin e vendeve të tjera për të dhënë një mendim përfundimtar lidhur me këtë.

Ermonela Felaj – Zoti Duzha e ka fjalën.

Luan Duzha – Qytetet tona janë mbushur me kafshë endacake, të cilat janë bërë problem si për fëmijët, por edhe për ne të rriturit. Shkojmë në bashki dhe ata na thonë se nuk kanë zgjidhje. Si do të zgjidhet kjo punë? Çfarë mendoni ju si shoqatë?

Ermonela Felaj – Shoqata ka menduar se duhet t'i ndëshkojnë ata që i dhunojnë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ilir Bejko – Nuk është e vërtetë që po i hanë fëmijët, megjithatë mund t’ju them se çfarë është duke u bërë aktualisht nga të gjitha bashkitë. Pra, këto kafshë vriten me çifte apo duke i helmuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, në qoftë se ju doni zgjidhjen, zgjidhja është ajo që ka kaluar çdo vend i civilizuar, duke bërë sterilizimin, heqjen e organeve riprodhuese të të gjitha kafshët e rrugës dhe ata në 4-5 vjet pakësohen në mënyrë të natyrshme dhe nuk ka nevojë t’i vrasësh.

(Diskutime pa mikrofon)

Siç e bën çdo vend i civilizuar.

Ermonela Felaj – Dakord.

Ju lutem, të mos kalojmë në sugjerime të tjera, sepse ato janë objekt i punës së ligjeve të veçanta dhe jo objekt i këtij komisioni.

Ilir Bejko – Më falni, doja të jepja vetëm një shembull....

Ermonela Felaj – Të respektojmë atë pjesë për të cilën jemi mbledhur.

Kolegë, këtu mbyllen pyetjet dhe diskutimet nga të gjitha palët. A jeni dakord me sugjerimin që ju shpreha pak më parë, që kjo nismë të ripunohet, duke e bërë në një kontributin e organizatës në ndihmë të kafshëve së bashku me atë të institucioneve qendrore, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Mjedisit, të cilat natyrisht do t’i jepen formën e duhur dhe do të reflektonin atë çka vërtetë lipset të reflektohet në Kodin tonë Penal?

A jeni dakord? Kundër? Nuk ka.

Ju falënderoj për prezencën!

Punë të mbarë dhe ju uroj për nismën!

MBYLLET MBLEDHJA